



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 75/4 prot.

Tiranë, më 05.06.2026

V E N D I M

Nr. 154, datë 05.06.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 13, datë 09.01.2026, e paraqitur nga z. A.B kundër Ministrisë së Arsimit, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin e djalit të tij të mitur F.B , për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, pala ankuese parashtron: “*Quhem A.B. Jam banor i Bashkisë Korçë. Po ju drejtohem ju si institucion për shkak të një padrejtësie që më është bërë lidhur me zbatimin e VKM 666 datë 10.10.2019, për përfitimin e bursës për djalin tim, i cili vazhdon studimet në shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, klasa 8. Është viti i tretë që fëmija im nuk e përfiton këtë bursë edhe pse i takon pasi plotëson të gjitha kriteret e miratuara në këtë VKM. Jam person me aftësi të kufizuara dhe një ndër pikat e kësaj VKM është 2.3/d. Më poshtë po jap shpjegimin e situatës.*

Në tetor 2025 përgatit dokumentacionin dhe e dorëzoj në shkollë pranë drejtorisë. Lajmërohem nga mësuesja kujdestare e fëmijës tim që dokumentacioni i nxjerrë nga e-albania lidhur me aftësinë e kufizuar nuk ishte i duhuri, pasi dilte që trajtohem me ndihmë ekonomike. Për këtë arsye në datë

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

15.10.2025 nxjerr dokumentin e duhur dhe e ridorëzoj në shkollë, e cila nuk ma pranon se dosja ishte dorëzuar ndërkohë që afati ka qenë 1 muaj, pra deri në datë 31 tetor.

Në muajin dhjetor interesohem në shkollë ku më thonë që fëmija im nuk është përfitues edhe pse dokumentet janë të rregullta. Interesohem në institucionin përkatës që në këtë rast është Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdheve dhe specialistja e kësaj zyre më thotë që nuk ka fonde mjaftueshëm për të gjithë”.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përfitimin e bursës për djalën e tij F.B .

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Sipas nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.75/1 prot, datë 19.01.2026, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Arsimit, Bashkia Korçë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë.
2. Me shkresën nr. 61 prot., datë 23.01.2026, ka kthyer përgjigje Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë, duke parashtruar ndër të tjera se:

“Vlerësimi i kriterëve për përcaktimin e kuotave financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimi i kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, bëhet duke u bazuar në :

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” dhe Vendimin nr.511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” Kurse procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që kërkohet për përfitimin e bursës jemi bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr.86, datë 29.08.2025 “Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”.

Z. A.B ka kërkuar bursë për fëmijën e tij F.B nxënës në shkollën “Asdreni”. Sipas informacionit nga Drejtoria e Shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë shkollës. Nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe së bashku me dokumentet e aplikuesve të tjerë janë dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

Nxënësi nuk ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2025-2026 për shkak se të dy prindërit nuk kanë qenë të regjistruar si punëkërkues të papunë në zyrën e punës. Gjithashtu në dokumentet që kanë dorëzuar nuk kanë dorëzuar dhe certifikatën personale të nxënësit. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë shkollës nxënësi është klasifikuar në kriterin ekonomik 2.1.c, kurse nga ana e prindërve në ankesë thuhet që babai është person me aftësi të kufizuara dhe duhet të ishte klasifikuar sipas kriterit joekonomik pika 2.3.d.

Sqarojmë se në dosjen e dokumenteve që janë dorëzuar në NSHMAÇ nuk ka asnjë dokument që na vërteton se prindi është me aftësi të kufizuara ndaj dhe shkolla e ka klasifikuar në kriterin ekonomik pika 2.1.c.

Nxënësi nuk ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2024-2025 dhe arsyeja e mospërfitimit ka qenë mungesa e vërtetimeve nga zyra e punës për të dy prindërit të cilët duhet të ishin regjistruar

si punëkërkuës të papunë si dhe për të atin ka pasur vetëm një fletë dalje nga spitali dhe rekomandim, jo vërtetim që trajtohet me KEMP për shkak të aftësisë së kufizuar.

Për vitin shkollor 2025-2026, për shkak se nga Ministria e Arsimit shkresa për planifikimin e numrit të bursave nuk erdhi në muajin shtator, si vitet e tjera, procedura e njoftimit filloi në datën 06.10.2025. Njoftimi i shkollave u bë nëpërmjet e-mailit dhe njëkohësisht u publikua dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Modelet e procesverbaleve u hartuan nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e miratuar me VKB-në nr. 86, datë 29.08.2025 dhe ju dërguan të gatshme drejtorive të shkollave dhe u udhëzuan t'i plotësonin në momentin që prindërit dorëzonin dokumentet, si dhe një kopje të firmosur nga të dyja palët t'ia jepnin prindërve. Shkresa për planifikimin e bursave nga Ministria e Arsimit ka ardhur në datën 21.10.2025, protokolluar nga Bashkia Korçë. Në këtë shkresë Ministria kërkonte nga ana jonë numrin e aplikimeve brenda datës 27.12.2025. Me shkresën nr. 884 prot., datë 27.10.2025 kemi kthyer përgjigje dhe kemi dërguar numrin e aplikantëve. Duke qenë se afati për dorëzimin e dokumenteve filloi me vonesë ne kemi marrë dokumentacionin deri në datën 31.10.2025, dhe deri në këtë datë kanë qenë 703 aplikime gjithsej.

Nga Ministria e Arsimit për vitin shkollor 2025-2026 numri i bursave të miratuara ka qenë 280 bursa, 70 bursa më pak nga viti i kaluar. Nga fondet e bashkisë janë akorduar 40 bursa, maksimumi që mund të jepej bazuar në buxhetin e bashkisë. Në total për vitin shkollor 2025-2026 kemi pasur 320 bursa.

Duke parë që numri i aplikantëve, me dokumentacion të rregullt brenda afateve është shumë më i lartë se numri i bursave (542 aplikime të rregullta) nga ana jonë bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak janë përzgjedhur 320 aplikimet e para që janë dorëzuar pranë shkollave duke u mbështetur në datat e procesverbaleve të aplikantëve. Për pjesën tjetër të nxënësve të cilët janë me dokumentacion të rregullt, konkretisht 222 nxënës, i jemi drejtuar me shkresën nr. 993 prot., datë 03.12.2025 Ministrisë së Arsimit për mbulimin me kuota për bursa për këta nxënës të cilët nuk përfituan. Nga Ministria e Arsimit na ka ardhur shkresa nr. 7802/1, datë 15.12.2025 ku thuhet që ministria e ka bërë shpërndarjen e bursave duke lënë të kuptohet që nuk do të ketë më fonde për bursa.

Këto problematika janë shkaktuar nga mungesa e fondeve të transferuara nga ministria përkatëse, pasi nuk arrin të mbulojë kërkesat e të gjithë aplikantëve për bursë.”

3. Me shkresën nr. 576/2 prot., datë 12.02.2026, ka kthyer përgjigje Ministria e Arsimit, duke parashtruar:

“Ministria e Arsimit me shkresën nr. 576/1, datë 28.01.2026, të përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Tiranë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Korçë ka kërkuar informacion mbi ankesën e paraqitur.

ZVAP Korçë me shkresën nr.73 prot., datë 28.01.2026, protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr.870 prot., datë 30.01.2026, ka dërguar dokumentacionin e disponuar nga shkolla 9-vjeçare “Asdreni”. Gjithashtu, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike³ nga kjo zyrë bëhemi me dije se nxënësi F.B. nuk rezulton përfitues i bursave në vitin shkollor të kaluar.

Lidhur me pyetjet për të cilat kërkohet informacion drejtpërdrejtë nga Ministria e Arsimit, sqarojmë se:

Në zbatim të pikës 6, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitar publike”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit me anë të shkresës nr. 7094/1 prot., datë 06.11.2025 me lëndë: “Dërgohet plani i bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2025”, ka bërë me dije njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar mbi planin e shpërndarjes së bursave.

Bazuar në vendimin e sipërcituar, si dhe duke mbajtur në konsideratë numrin e përgjithshëm të nxënësve nga klasa 1-rë deri në klasën e 12-të për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, shpërndarjen e tyre gjeografike, numrin e bursave të miratuara në vitet e kaluara shkollore dhe fondin në dispozicion për mbështetje financiare të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026, u miratua plani për 3871 përfituesve të bursave, në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, nga të cilat 280 janë miratuar për Bashkinë Korçë.

Gjithashtu, vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5, të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin, i njeh të drejtën njësitë të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë.

Sa i përket kërkesës për informacion nëse fakti që një nxënës që ka njërin nga prindërit me aftësi të kufizuara, a e bën që të jetë drejtpërdrejtë përfitues i bursës, sqarojmë se sipas shkronjës “b”, të pikës 2.3, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursa brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

“2.3. Kriteri joekonomik:

b) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit.”

Sa më sipër, në zbatim të pikës 8, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin

³ E-mail i datës 28.01.2026 nga ZVAP Korçë.

e bursave e të pagave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitar publike”, i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave është kompetencë e njësisë së vetëqeverisjes vendore.....”

4. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 387 prot, datë 18.02.2026, njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.03.2026, ora 10.00, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvilluar në datën 05.03.2026. Gjatë seancës dëgjimore të datës 05.03.2026, pala ankuese nuk mori pjesë, ndërsa palët e tjera, konkretisht Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, morën pjesë. Palët e pranishme, Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me Komisionerin.

5. Me shkresën 1025/1 prot., datë 12.03.2026⁴, Ministria e Arsimit ka dërguar informacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore, duke sqaruar ndër të tjera se:

“Në zbatim të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, Ministria e Arsimit, me qëllim që çdo nxënës t'i sigurohet e drejta për arsimim në institucionet publike të arsimit parauniversitar, bën shpërndarjen e bursave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa përfshirë nxënësit që ndjekin arsimin profesional.

Bazuar në vendimin e sipërcituar, Ministria e Arsimit miraton çdo vit kuotat e bursave në përputhje me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për këtë ministri, duke mbajtur në konsideratë numrin e përgjithshëm të nxënësve nga klasa 1-re deri në klasën e 12-të për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, shpërndarjen e tyre gjeografike, numrin e bursave të miratuara në vitet e kaluara shkollore dhe fondin në dispozicion për mbështetje financiare të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, si dhe

⁴ Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 129/1 prot., datë 17.03.2026.

mbi bazën e të dhënave të raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet arsimore.

Procesi i përcaktimit të kuotave realizohet mbi bazën e kritereve objektive dhe të njëjta për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke synuar garantimin e një shpërndarjeje të balancuar të fondeve publike në nivel kombëtar dhe respektimin e kufijve buxhetorë të miratuar.

Në zbatim të pikës 8, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e lira të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Referuar sa më sipër, Këshilli i Bashkisë Korçë me vendimin nr. 86, datë 29.08.2025, ka miratuar dokumentacionin dhe procedurën për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore parauniversitare.

Në shkronjat "h" dhe "i" të pikës 3 të këtij vendimi parashikohet se:

h) Në rast se numri i përfituesve, sipas listës së lartpërmendur, është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës.

i) Rast pas rasti, në varësi të buxhetit, Bashkia mund të mbështesë me bursa ata aplikantë të cilët nuk mbulohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit, por që dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është i rregullt dhe brenda afatit të dorëzimit.

Referuar faqes zyrtare të Bashkisë Korçë, rezulton se dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë sekretarive të shkollave, deri më datën 29 Tetor 2025. Në vijim të këtij njoftimi, shkollat kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë brenda afatit të shpallur, edhe për ata nxënës që nuk kanë përfituar bursa.

Lidhur me masat e marra, si dhe analizat afatmesme apo afatgjata të bëra nga Ministria e Arsimit në lidhje me ecurinë e kërkesave për bursa, sikurse kemi bërë me dije edhe me shkresa të mëparshme, ritheksojnë se me vendimin nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt Akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026", është parashikuar që Ministria e Arsimit do të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 666,

datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', i ndryshuar".

Ky projektvendim është propozuar për miratim me qëllim qartësimin mbi mënyrën e ndarjes së bursave sipas kuotave për nxënësit që plotësojnë kriteret, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Miratimi i projekt aktit synon të rregullojë çështjet që lidhen me qartësimin e mënyrës së përfitimit të kuotave financiare për rastet kur numri i nxënësve që plotësojnë kriteret është më i lartë se numri i kuotave të miratuara.

Në zbatim të vendimit nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026", Ministria e Arsimit ka miratuar urdhrin nr. 8, datë 13.1.2026, "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt akteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2026".

Grupi i punës është duke hartuar projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar", i cili do t'i dërgohet për mendim edhe grupeve të interesit.

Në lidhje me rritjen e numrit të aplikimeve për bursa në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë Korçë, theksohet se dinamika e aplikimeve për bursa mund të ndryshojë nga një vit në tjetrin në varësi të faktorëve socialë dhe ekonomikë. Megjithatë, numri i bursave që mund të miratohet çdo vit është i kushtëzuar nga fondi buxhetor i miratuar për këtë qëllim dhe nga nevoja për të siguruar një shpërndarje të balancuar të këtij fondi në nivel kombëtar.

Lidhur me faktin se për vitin shkollor 2025-2026 është miratuar një numër më i ulët bursash krahasuar me vitet paraardhëse (2023-2024 dhe 2024-2025), sqarohet se përcaktimi i kuotave bëhet në funksion të fondit të miratuar në buxhetin e shtetit dhe në bazë të analizës së kërkesave të paraqitura nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në pikën 30 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, përcaktohet se: "Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (njëmijë e dyqind) bursa ..."

Në zbatim të pikës 6 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për arsimin, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilin e dërgon në njësitë e vetëqeverisjes vendore jo më vonë se muaji tetor.

Për vitin shkollor 2023-2024, me anë të shkresës nr. 6470/52 prot., datë 20.11.2023 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024", është dërguar numri i bursave të miratuara, 3804 në total, nga të cilat 350 për Bashkinë Korçë.

Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 175 bursa.

Për vitin shkollor 2024-2025, nga Ministria e Arsimit janë miratuar 3818 në total. Për Bashkinë Korçë janë miratuar 350 bursa, dërguar me shkresën nr. 7228/37 prot., datë 18.11.2024 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025".

Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor nuk ka miratuar bursa.

Për vitin shkollor 2025-2026, me anë të shkresës nr. 7094/1 prot., datë 06.11.2025 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026", është dërguar numri i bursave të miratuara, 3871 në total, nga të cilat 280 janë miratuar për Bashkinë Korçë.

Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 40 bursa.

Sa më sipër, numri i bursave të miratuara nga Ministria e Arsimit në nivel kombëtar ka qenë në rritje. Për rrjedhojë, fakti që në një njësi të caktuar vendore numri i aplikimeve për bursa mund të tejkalojë kuotat e miratuara, nuk përbën në vetvete trajtim të pabarabartë apo diskriminues, për sa

kohë që kriteret e përfitimit dhe procedurat e përzgjedhjes zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë aplikuesit që ndodhen në kushte të njëjta faktike dhe ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të pikës 8 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollë, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë".

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

Në bazë të certifikatës familjare të lëshuar në datën 06.10.2025, nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, rezulton se subjekti ankues, z. A.B , është babai i fëmijës F.B . Djali i ankuesit, F.B , është nxënës në klasën e VIII-të (tetë), të shkollës 9-vjeçare "Asdreni" Korçë, fakt ky që rezulton i provuar sipas vërtetimit datë 22.10.2025, lëshuar nga shkolla 9-vjeçare "Asdreni" Korçë.

Sipas dokumentacionit të administruar, babai i nxënësit F.B , z. A.B , gëzon statusin e personit me aftësi të kufizuara, pasi trajtohet me pagesë paaftësie, fakt ky që rezulton i provuar sipas vërtetimit të lëshuar në datën 15.10.2025, nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë.

Referuar certifikatës së gjendjes familjare, nxënësi F.B figuron si pjesëtar i familjes, e cila përbëhet prej 4 personash, babai z. A.B si kryefamiljar, nëna znj. R.B. dhe motra R.B.

Sipas vërtetimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, lëshuar elektronikisht nga Shërbimi Social Shtetëror, rezulton se familja është përfituese e ndihmës ekonomike.

Nga provat e administruara rezulton se dokumentacioni i aplikimit u dorëzua nga prindi pranë Shkollës dhe se, u pranua dhe u shqyrtua nga grupi i punës së NSHMAC së bashku me të gjitha aplikimet e tjera të dorëzuara nga nxënësit për bursë.

Rezultoni se ankuesi ka depozituar aplikimin dhe dokumentacionin për të përfituar bursë për djalin e tij F.B , nxënës në shkollën “Asdreni” Korçë në datën 07.10.2025 dhe midis tij dhe shkollës është mbajtur procesverbali datë 07.10.2025, sipas të cilit rezultoni se aplikimi është klasifikuar sipas kriterit ekonomik 2.1. Referuar këtij procesverbali nuk rezultoni që ankuesi të ketë pasur probleme lidhur me dorëzimin e dokumentit të kërkuar certifikatë personale, fakt ky që konfirmohet nga procesverbali i mbajtur nga shkolla por edhe procesverbali i dorëzuar nga *NSHMAÇ*.

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë sqaron se, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë shkollës nxënësi është klasifikuar në kriterin ekonomik 2.1.c dhe nuk ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2025-2026 për shkak se prindërit nuk kanë qenë të regjistruar si punëkërkues të papunë në zyrën e punës si dhe gjithashtu nuk është paraqitur certifikata personale e nxënësit. Në përgjigjen e saj, *NSHMAÇ* thekson se, në dosjen e dokumenteve që janë dorëzuar pranë saj nga ana e shkollës nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se prindi i nxënësit është me aftësi të kufizuara ndaj dhe shkolla e ka klasifikuar në kriterin ekonomik pika 2.1.c. *NSHMAÇ*.

Referuar shkresës nr. 740/1 prot., datë 17.10.2025, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Korçë, nëpërmjet të cilit është përcjellë informacioni pranë *NSHMAÇ* mbi familjarët që kanë statusin punëkërkues të papunë, rezultoni se, bashkëshortja e ankuesit znj. R. B, figuron si punëkërkuese e papunë.

Pala ankuese, pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në shkelje të pikës 2.3.d, të VKM-së nr. 511, datë 27.7.2022 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriteve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*”, të ndryshuar, duke mos u trajtuar rasti i djalit të tij, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës si nxënës, fëmijë i një personi i cili gëzon statusin si person me aftësi të kufizuara, për vitin shkollor 2025 -2026. Kërkimi i ankuesit para Komisionerit lidhet me konstatimin e diskriminimit për shkak të *aftësisë së kufizuar* pasi nxënësi F.B , është fëmijë i një personi që gëzon statusin si person me aftësi të kufizuara, në rastin konkret z. A.B babai i tij, i cili është person me aftësi të kufizuara dhe përfitimin e bursës për djalin e tij për vitin shkollor 2025-2026.

Rezultoni se, aplikimi i palës ankuese është klasifikuar në kuadër të kriterit ekonomik sipas pikës 2.1.c, të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar dhe është refuzuar për shkak të mos plotësimit të kriterit, me justifikimin se prindërit e nxënësit nuk kanë qenë të regjistruar si punëkërkues të papunë në zyrën e punës dhe nuk është depozituar certifikata personale e fëmijës. Në kushtet kur rezultoni e provuar se familja trajtohet me ndihmë ekonomike, Komisioneri do të vlerësojë nëse fëmija i ankuesit, nxënësi F.B është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm për shkak të gjendjes ekonomike.

Në kontekst të legjitimitit të ankuesit kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Korçë gëzon legjitimitim pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin (si entitet) për miratimin e dhënien e bursave.

Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë (Ndërmarrja), nuk gëzon legjitimitin pasiv për pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me mospërfitimim e bursës për djalin e tij, pasi nuk ka tagrin e miratimit të dhënies së bursës.

Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka Ndërmarrja, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të bursës, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e Ndërmarrjes dhe ndikimin që ato kanë pasur tek vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin/mosmiratimin e bursës. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin e dhënies së bursave është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga NSHMAÇ dhe e kufizuar në listën e aplikantëve përfitues, të përcjellë prej saj.

Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankuesit, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të saj nga ana e Bashkisë Korçë.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 1, të tij përcakton se: “Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse”.

Neni 9, pika 1.1/ç), i Ligjit⁵, përcakton se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës: ...ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre”.

Në nenin 24⁶, i Ligjit, përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, ndër të tjera dhe: “... Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj. sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike, janë përcaktuar në nenin 33, të Ligjit, duke parashikuar se:

⁵ Referuar ligjit sipërcituar me nr. 139/2015, i ndryshuar.

⁶ Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

- a) njësi organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;*
- b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;*
- c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;*
- ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.*

.....

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.”

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:*

...4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

...

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.”

VKM nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:*

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë....”.

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar faktin nëse djali i ankuesit plotëson kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike, në zbatim të pikës 2.3.d dhe 2.1/c të VKM-së sipërcituar, si dhe, nëse skualifikimi i saj për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (*lex superior*), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike. Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga gjendja ekonomike e personit. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Kështu, në nenin 57, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“ 1.Kushdo ka të drejtën për arsimim.

.....

5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.”

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁷⁷.

⁷⁷ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, sipas formulimit vijues: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Në nenin 2 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ, ku sanksionohet e drejta për arsimim, përcaktohet: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim.”* Ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”*.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁰. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹¹.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës¹² është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës.

Disa nga të drejtat kryesore të fëmijëve, sipas Konventës, janë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim: të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta. Asnjë prej tyre nuk mund të diskriminohet për shkak gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, *gjendjes ekonomike*, arsimore dhe sociale, si dhe për çdo shkak tjetër.

Interesi më i lartë i fëmijës: Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e të Drejtave të Fëmijës duhet t'u sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e nevojshme të gjithë fëmijëve. Ato angazhohen ta realizojnë këtë duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe personave të tjerë ligjërisht përgjegjës duke marrë masat e nevojshme legislative dhe administrative.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

⁸ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábán kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁹ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁰Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹¹ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

¹² Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

Në nenin 28 e 29, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës¹³, parashikohet se:

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

- a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*
- e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

- (a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;*
- (b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.*

Referuar nenit 4, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, shtetet palë angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohen parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ligji përcakton se: “...2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.”

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

¹³ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991.

Kështu, në ligjin 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se:

Neni 5. E drejta për arsimim.

1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.
2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm i lartë janë falas.

Neni 6. Parime të përgjithshme.

4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.
5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.
6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.

Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Në pikën 2, 3, 4 dhe 5, të këtij vendimi përcaktohet se:

“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Kriteri ekonomik:

.....

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

.....

.....

2.3 Kriteri joekonomik:

.....

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit”.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin Nr. 148, datë 22.07.2022, ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, Komisioneri i është drejtuar Këshillit të Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

Lidhur me këtë, në zbatim të vendimmarrjes së Komisionerit, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike””, të ndryshuar, duke bërë përfitues në ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2.1 “Kriteri ekonomik”, shkronja c) ndryshoi si vijon: “...nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë”....

Sa i përket ndryshimeve të bëra në VKM-në nr. 666/2019, Këshilli i Ministrave me shkresën nr. 4305/2 prot., datë 02.09.2022, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Shkronja “c”, e nënpikës 2.1, të pikës 2, ka ndryshuar si vijon:... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

Ky ndryshim u bë në zbatim të kërkesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të kërkesës së subjektit “Qendra T’Reja”, që e vlerëson si pengesë dhe diskriminuese përdorimin e togfjalëshit “braktisje shkollore” duke e lidhur përfitimin e bursës me të qenit braktisës. Parashikimi i kësaj pike është bërë me qëllim rritjen e aksesit në arsim, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit e disavantazhuar. Bursa për fëmijët e familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë por janë në pamundësi financiare, është parashikuar të jepet pikërisht për të mundësuar ndjekjen e arsimit...”. Pavarësisht se, Këshilli i Ministrave, nëpërmjet shkresës nr. 4305/2 prot., datë 02.09.2022, informoi se VKM-në nr. 666/2019, ka ndryshuar në zbatim të rekomandimit, Komisioneri vlerëson se togfjalëshi i ndryshuar nga “braktisje shkollore” në “nuk ndjekin arsimin bazë”, literalisht ngre paqartësi dhe rekomandimi i dhënë nëpërmjet vendimit Nr. 148, datë 22.07.2022, nuk konsiderohet i zbatuar.

Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, të tij, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji.

Në nenin 4, të këtij Ligji, ndër të tjera përcaktohet se:

“Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

.....

c) “Bashki/njësi administrative”, është institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetje me të ardhura monetare ose/dhe në natyrë, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të punësimit, strehimit;

d) “Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;

e) “Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe, në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;

.....

k) “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

Në kreun II, “Përfituesit e asistencës sociale”, neni 6, i po këtij Ligji, përcakton se: “Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantoohen nga ky ligj.”

Sipas neni 7, “Përfituesit e ndihmës ekonomike”, shkronja a, e tij, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

Komisioneri, vëren se, kjo familje trajtohet me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë Korçë, në zbatim të drejtë të neni 7/a, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas përcaktimeve të neni 3, të tij, i cili zbatohet për familjet në nevojë, si një nga kategoritë përfituese të tij. Pra, kur Bashkia Korçë ka cilësuar familjen e ankuesit si familje përfituese të ndihmës ekonomike, automatikisht e ka konsideruar si familje në nevojë, që nuk ka të ardhura të mjaftueshme.

Në e-mailin e datës 03.10.2025, që iu është dërguar shkollave nga ana e NSHMAÇ, thuhet se: “Ju sqaroj që në pikën 2.1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak përfshihen të gjithë nxënësit që vijnë nga familjet në nevojë, që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe që kanë prindërit e papunë.” në radhë të parë nuk rezulton që VKB nr. 86, datë 29.08.2025, të parashikojë një pikë 2.1. Nisur nga formulimi i mësipërm, kuptohet se, bëhet fjalë për pikën 2.1 të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, i cili ka të bëjë me kriterin ekonomik. Në këtë kontekst, rezulton se, Bashkia Korçë, interpreton se sipas pikës 2.1/c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, përveç se familja duhet të trajtohet me ndihmë ekonomike duhet që prindërit e nxënësit të jenë të papunë.

Me vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr.86, datë 29.08.2025 “Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitim të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, është përcaktuar procedura dhe dokumentacioni i nevojshëm që kërkohet për të aplikuar për bursë. Referuar këtij akti, përcaktohet se për kriterin ekonomik sipas pikës 2.1 dhe kriterit joekonomik sipas pikës 2.3.d, përcaktohet kërkohet dokumentacioni i mëposhtëm:

“Sipas pikës 2.1 kriteri ekonomik

Dokumentet që nevojiten për të aplikuar sipas këtij kriteri të jenë:

- *Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);*
- *Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);*
- *Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);*
- *Vërtetim nga konviktet (mbi regjistrimin apo pamundësinë për akomodim);*

- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtar madhor të familjes (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim pagese pensioni pleqërie (shkarkohet nga e-albania, tek rubrika Kontributet dhe pensioni; Vërtetim pensioni);

Sipas pikës 2.3 kriteri joekonomik

.....

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave (prindërit/prindërve) që gëzojnë statusin e invalidit;

- Certifikatë personale (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Certifikatë familjare (Mund të shkarkohet nga e-albania);
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve; (Mund të shkarkohet nga e-albania ose të merret tek Njësia Administrative);
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo anëtar madhor të familjes (Shkarkohet nga e-albania, tek rubrika DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE. Vërtetim për individë të paregjistruar);

Në pikën 2, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr.86, datë 29.08.2025 “Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, përcaktohet :

“Dokumentacioni që ka lidhje me regjistrimin si punëkërkues i papunë për çdo anëtar madhor të familjes, vërtetimi mbi statusin e jetimit dhe pagesën e kujdestarisë si dhe vërtetimi mbi statusin e invaliditetit paraplegjik dhe pagesën e PAK, do i vendoset në dispozicion NSHMAÇ nga Drejtoria e Kujdesit Social.”

Komisioneri konstaton se, vërtetimi si punëkërkues i papunë, për personat madhorë të familjes, nuk është parashikuar nga VKB nr.86, datë 29.08.2025, në kuadër të kriterit ekonomik, pika 2.1.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Korçë interpreton në mënyrë të gabuar pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së, pasi, ajo përcakton shprehimisht se: “:... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”. Sikurse shihet, VKM-ja e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare, pamundësi e cila rezulton e provuar me faktin që familja e nxënësit F.B trajtohet me ndihmë ekonomike.

Pra, kushti kumulativ dhe cilësimet: me ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalësha të shtuar nga ana e Bashkisë dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së përkatëse, dhe përfitues sipas kësaj pike të VKM-së, duhet të jenë nxënësit, “...fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”.

Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, parashikon në nenin 15, se përjashtohen nga ndihma ekonomike të familjeve të cilat kanë në përbërjen e tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që është në moshë aktive pune dhe i aftë për punë, që nuk rezulton punëkërkuar i papunë pranë zyrave të punës. Konkretisht pika 1, germa “e” dhe pika 2, germa “a”, të ligjit të sipërcituar sanksionon se: “1. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmuajore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme:e) kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat;..... 2. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme: a) është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;...”

Në momentin që, familja rezulton përfituese e ndihmës ekonomike është certifikuar edhe fakti nëse personat madhorë të familjes të aftë për punë figurojnë të regjistruar në zyrën e punës.

Sikurse rezulton edhe nga shkresa nr.740/1 prot., datë 17.11.2025, e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Korçë, rezulton se bashkëshortja e ankuesit znj. R.B, figuron e regjistruar si punëkërkuar e papunë. Z. A.B, duke qenë person me aftësi të kufizuara, pasi përfiton pagesë paaftësie, sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë nuk konsiderohet si person në moshë aktive pune i aftë për punë. Nëse do të ishte ndryshe, familja nuk do trajtohej me ndihmë ekonomike dhe nuk do të ishte vlerësuar si familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas nenit 7, shkronja “a”, të ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

VKM Nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në ndarjen I, pika 2 parashikon ndër të tjera se: “2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë: a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;...”

Në ndarjen II, të VKM-së “Procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”, parashikohet se: “1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:

a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për:

i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;

ii) llojin e banesës;

iii) pasuritë/asetet familjare;

iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij...

3. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

4. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike...

.....

.....

8. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

.....

.....

c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë:

i. për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

ii. për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike...”.

Pra, bazuar në sa më sipër, Bashkia përmes strukturave vartëse të saj, ndjek procesin e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, ku pjesë e procesit të verifikimit janë edhe të ardhurat e familjeve që kanë aplikuar. Gjithashtu, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, i nënshtrohen verifikimit çdo 3 (tre) muaj, nga ana e administratorit shoqëror, lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes.

Pamundësia financiare dhe qenia e familjes së ankuesit një familje në nevojë është fakt i njohur dhe pranuar nga Bashkia Korçë, pasi bazuar pikërisht mbi këto cilësi¹⁴ ajo trajtohet me ndihmë ekonomike, si familje në nevojë, që nuk ka të ardhura të mjaftueshme.

Pra, përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, fëmija i ankuesit, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfitues i bursës, si fëmijë i një familjeje në nevojë. Për

¹⁴Neni 7/a), i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citon se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

kategoritë e nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon përfitimin e ndihmës ekonomike, ky fakt është i mjaftueshëm dhe provon plotësisht kriterin e kërkuar sipas pikës 2.1.c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar. Pamundësia financiare, si kriter i vendosur sipas kriterit 2.1.c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, provohet plotësisht me faktin që familja e nxënësit është përfituese e ndihmës ekonomike.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, deklaratimet e veprimet e Bashkisë Korçë, nuk qëndrojnë dhe bien në kundërshtim me faktet, provat e legjislacionin e analizuar më sipër.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se djali i ankuesit, nxënësi F.B , i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me mospërfshirjen e tij në listën e përfituesve të bursës për vitin shkollor 2025-2026, sipas përcaktimeve të pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se fëmija i tij duhet të ishte përfitues sipas kriterit joekonomik pika 2.3.d të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, pasi ankuesi z. A.B , i cili është babai i nxënësit F.B , është me person me aftësi të kufizuara, nga aktet e administruara rezulton se, sipas procesverbalit të mbajtur midis z. B. dhe shkollës, nuk provohet se dokumenti që vërteton aftësinë e kufizuar të z.B. t’i jetë përcjellë Bashkisë Korçë.

Sipas shkresës nr.73 prot., datë 28.01.2026, të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Korçë-Pustec, konstatohet se nga ana e shkollës “Asdreni”, disponohet vërtetimi datë 15.10.2025, i lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë, por nuk provohet që ky dokument t’i jetë përcjellë Bashkisë Korçë, pasi nuk pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur midis shkollës dhe ankuesit z.B.

Nga aktet e administruara provohet se, fëmija i ankuesit, nxënësi F.B , do të duhet të ishte përfitues i bursës edhe sipas kriterit joekonomik, sipas pikës 2.3.d të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, pasi është nxënës fëmijë i një prindi me aftësi të kufizuara, konkretisht z. B, gëzon statusin si person me aftësi të kufizuara pasi trajtohet me pagesë paaftësie, por nuk provohet që një dokument i tillë të jetë depozituar pranë Bashkisë Korçë apo që Bashkia Korçë të ketë patur indicie se aplikimi i palës ankuese ka qenë në kuadër të kriterit 2.3.d, pasi shkolla ka mbajtur procesverbal aplikimi vetëm për kriterin joekonomik, sipas pikës 2.1.c.

Në lidhje me subjektin tjetër kundër të cilit është paraqitur ankesa Ministria e Arsimit, Komisioneri vlerëson se nga ana e këtij institucioni nuk janë kryer veprime ose mos veprime të cilat kanë cenuar të drejtën e fëmijës së ankuesit. Rezultoi e provuar se, mospërfitimi i bursës për vitin shkollor 2025-2026 për fëmijën e ankuesit, nxënësin F.B , ka ardhur si rezultat i interpretimit dhe zbatimit të pabazuar të kriterit ekonomik pika 2.1.c parashikuar nga VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Korçë, që është autoriteti përgjegjës sipas kësaj VKM për miratimin dhe dhënien e bursave sipas kriterëve të parashikuara në VKM.

Komisioneri konstaton se në rastin e ankesës objekt shqyrtimi, mospërfitimi i bursës për fëmijën e ankuesit, nuk ka ardhur si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të bursave të Miratuara nga Ministria e Arsimit për Bashkinë Korçë.

B. Shkaku i mbrojtur

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të *gjendjes familjare dhe përkatësisë prindërore*, të pretenduar nga pala ankuese si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësi F.B , fëmija i ankuesit z.A.B , është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar të drejtën e garantuar ligjërisht për përfitimin e bursës për nxënësit e arsimit parauniversitar.

Në parim, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “*aftësia e kufizuar*” është një nga shkaqet që gëzon shprehimisht mbrojtje, sipas nenit 1, të LMD.

Sipas Vërtetimit të Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, vërtetohet se z. A.B është përfitues i pagesës së aftësisë së kufizuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e nxënësve që gëzojnë statusin ligjor si fëmijë të personit që gëzojnë statusin e invalidit, janë kategori që e mbartin shkakun e mbrojtur. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *aftësisë së kufizuar*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri çmon se ankesa objekt shqyrtimi duhet të trajtohet edhe në kuadër të shkakut të “*gjendjes ekonomike*”, shkak i cili gëzon mbrojtje sipas nenit 1, të LMD-së.

Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton pastaj në braktisjen e shkollës ose në arritjet e nxënësve.

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “*Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Ligji nr. 57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*” përcakton se: “*Ndihma ekonomike*”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, dhe se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe kanë fëmijë që ndjekin arsimin parauniversitar, është kategori e familjeve në nevojë që e mbartin shkakun e mbrojtur.

Ankuesi ka depozituar dokumentacion me anën e të cilit provon shkakun e gjendjes ekonomike dhe konkretisht vërtetimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, ku vërtetohet se familja e nxënësit F.B , trajtohet me ndihmë ekonomike.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet edhe bazuar në shkakun e *gjendjes ekonomike*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁵. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁶. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar *“pabarazitë faktike”* ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të

¹⁵ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁶Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

caktuara, dështimi në përpjekje për të korigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁷.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”. Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet nga Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, të të cilit, përcaktohet si vijon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.

¹⁷ Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁸

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtuara në këtë ankesë.

Në konkluzion të analizës sa më sipër, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, nxënësi F.B , (djali i ankuesit), nxënës në shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, fëmijë e një familjeje që, trajtohet me ndihmë ekonomike, i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me përjashtimin nga e drejta e përfitimit të bursës, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriteve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, të ndryshuar. Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i Këshillit të Ministrave për trajtimin me bursë të nxënësve, familjet e të cilëve janë në pamundësi financiare, pasi janë familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është i ligjshëm, pasi synon mbështetjen e tyre.

Identifikimi i shkakut të diskriminimit dhe analizimi i tij në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të konstatuar diskriminimin, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në çështjen në shqyrtim, Komisioneri ka identifikuar dhe vlerësuar se subjekti ankues posedon një shkak të mbrojtur nga LMD, atë të “*gjendjes ekonomike*”.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e braktisjes së shkollës.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t’u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Këshilli i Ministrave për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike apo që për arsye e shkaqe të tjera objektive janë konsideruar si pjesë e grupeve vulnerabël, si nga pushteti qendror dhe ai vendor, ka parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie, të konsideruar vulnerabël.

Bashkia Korçë ka pasur barrën e provës¹⁹ para Komisionerit për të provuar se pavarësisht faktit se familja e nxënësit F.B , trajtohet me ndihmë ekonomike, ka një justifikim të arsyeshëm e objektiv për përjashtimin e saj nga bursa.

Komisioneri gjen të padrejtë e të pajustificuar qëndrimin e Bashkisë, lidhur me përjashtimin e djalit të ankuesit nga përfitimi i bursës, pasi:

- Bashkia Korçë interpreton në mënyrë të gabuar pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së, pasi, ajo përcakton shprehimisht se: “... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare... ”. Sikurse shihet, VKM-ja e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare, pamundësi e cila rezulton e provuar me faktin që familja e nxënësit F.B trajtohet me ndihmë ekonomike.
- Kushti kumulativ dhe cilësimet e përdorura nga Bashkia Korçë “me ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë”, janë togfjalësha të shtuar nga ana e Bashkisë dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së. Përfitues sipas kësaj pike të VKM-së, duhet të jenë nxënësit, “...fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”.
- Në momentin që, familja rezulton përfituese e ndihmës ekonomike është certifikuar edhe fakti që është familje në pamundësi financiare, kushtet social-ekonomike të së cilës e përlligjin atë që të konsiderohet familje në nevojë dhe të trajtohet me ndihmë ekonomike sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Në momentin që, familja rezulton përfituese e ndihmës ekonomike është certifikuar edhe fakti nëse personat madhorë të familjes të aftë për punë figurojnë të regjistruar në zyrën e punës.

¹⁹ Në referencë të neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe pika 7/1, e nenit 33, të LMD-së.

- Rezulton se bashkëshortja e ankuesit znj. R.B, figuron e regjistruar si punëkërkuese e papunë. Z. A.B , duke qenë person me aftësi të kufizuara, nuk konsiderohet si person në moshë aktive pune i aftë për punë. Nëse do të ishte ndryshe, familja nuk do trajtohej me ndihmë ekonomike dhe nuk do të ishte vlerësuar si familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas nenit 7, shkronja “a”, të ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, djali i ankuesit, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfitues i bursës, si fëmijë e një familjeje në nevojë, njohur, pranuar dhe dëshmuar me dokumentacion (vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike) prej Bashkisë Korçë.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e Bashkisë, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga pala ankuese, që është gjendja ekonomike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e bashkisë, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt palës ankuese janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta, objektive dhe të arsyeshme.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se:

- Qasja e zbatuar nga Bashkia Korçë lidhur me pikën 2.1.c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, ku për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, kërkohet që prindërit të jenë punëkërkuës të papunë, verifikim që është kryer nga strukturat përgjegjëse të bashkisë që merren me ndihmën ekonomike, është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme.
- Në kushtet kur një aplikant provon me dokumentacionin përkatës se është përfitues i ndihmës ekonomike, atëherë provohet plotësisht se nxënësi, është fëmijë i një familje në nevojë dhe që është në pamundësi financiare.
- Praktika e ndjekur nga Bashkia Korçë, i ekspozon familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të cilët janë në moshë aktive pune por për shkak se janë me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë për punë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, gjatë procedurës së përfitimit të bursave, pasi mosregjistrimi si punëkërkuës i papunë në zyrën e punës i anëtarit/anëtarëve madhorë të familjes në moshë aktive pune, nuk vjen për fajin e tyre. Duke qenë persona me aftësi të kufizuara, nuk konsiderohet si person në moshë aktive pune i aftë për punë. Nëse do të ishte ndryshe, familja nuk do trajtohej me ndihmë ekonomike dhe nuk do të ishte vlerësuar si familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas nenit 7, shkronja “a”, të ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Bazuar në të dhënat e analizuar në vendim, Komisioneri vëren se, nxënësi F.B , plotëson kriterin e cilësuar në pikën 2.1/c, të VKM-së përkatëse, dhe ky fakt është i njohur dhe pranohet nga ana e

Bashkisë, pasi pikërisht për këtë arsye familja e tij është përfituese e ndihmës ekonomike nga strukturat e saj.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se djali i ankuesit, si anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike, është vënë në pozita jo të favorshme, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues. Pra, djali i ankuesit, nxënësi F.B , është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së tij.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, ka si vizion²⁰ mbrojtjen sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës.

Një nga objektivat specifik/strategjik²¹ të kësaj Strategjie është edhe “*përmirësimi i shënjestrimit të fëmijëve, vajza dhe djem përmes skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët*. Përmirësimi përfitimeve dhe bashkëpunimit ndër-sektorial me fokus fëmijët, vajzat dhe djemtë në skemën e ndihmës ekonomike me synim promovimin e mirëqenies së tyre.”

Ky dokument, ndër të tjera citon se: “*Analiza të mëparshme kanë theksuar nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme për familjet me fëmijë (të vegjël) në kushtet e pamjaftueshmërisë së skemave ekzistuese të mbështetjes në para dhe përfitimeve të tjera. Aktualisht ekzistojnë disa përfitime për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve në familjet në ndihmë ekonomike. Të tilla janë bonusi i bebes për çdo fëmijë të lindur, stimuli financiar për regjistrimin në shkollë dhe për vaksinimin, tekste shkollore falas, bursa mësimore etj. Ekzistojnë dhe shërbime të tjera që merren nga një sërë institucionesh lokale dhe qendrore të cilat duhen identifikuar dhe analizuar. Evidentimi i të gjithë llojeve të përfitimeve dhe shërbimeve, analiza e kostove që lidhen me mirërritjen e fëmijëve do të mundësojnë ndërtimin e skenarëve të ndryshëm për të përmirësuar këto përfitime. Ekzistojnë modele dhe praktika ndërkombëtare mbështetjeje me përfitime për fëmijët në familjet në ndihmë ekonomike, të cilat do të njihen dhe do të përdoren për ndërtimin e skenarëve të mbështetjes për fëmijët në të ardhmen. Analiza të vijueshme për impaktin e këtyre skemave në mirëqenien e fëmijëve do të kryhen me qëllim realizimin e modifikimeve të nevojshme.”*

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial me fokus fëmijët në programin e NE-së, citon se: “*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hedhur hapa të rëndësishëm dhe konkret drejt një modeli të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale për fëmijët përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. Njëkohësisht lidhja me arsimimin është thelbësore për të garantuar të drejtën e fëmijëve në nevojë për siguruar qëndrimin në shkollë. Në veçanti, orientimi drejt një modeli të koordinuar*

²⁰ 3.1 Vizioni

²¹ Objektivi specifik/strategjik A3.

mes shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësor pritet të jetë një prej prioriteteve të strategjisë së re për garantimin e mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve. Ky integrim i shërbimeve nis që në moshën 0-5 vjeç me paketën bazë të shëndetit të kujdesit parësor dhe programit të vizitave të integruara në familje si një mundësi për të adresuar në veçanti fëmijët vulnerabël, monitorimin e zhvillimit të hershëm dhe identifikimit të hershëm të aftësisë së kufizuar si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial për të siguruar ndjekjen e treguesve të zhvillimit të fëmijës. Ky program aktualisht po zbatohet në qarqet Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Berat dhe synimi është të zgjerohet në të gjithë territorin.

Hartimi i protokolleve të përbashkëta, organizimi i tryezave të përbashkëta në nivel rajonal mes shërbimeve sociale dhe atyre shëndetësore si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit socio-shëndetësor do të jenë në fokus në strategjinë e re. Njëkohësisht, pjesë e kësaj mase prioritare do të jetë vlerësimi i fizibilitetit, kapaciteteve institucionale dhe personelit për të hartuar një Plan Veprimi për Garancinë e Fëmijëve sipas modelit dhe udhëzimeve të Bashkimit Evropian. Hartimi i një Plani Veprimi për Garancinë e Fëmijëve është një prej rekomandimeve të Bashkimit Evropian si pjesë e kapitullit 19 për hapjen e negociatave si dhe në përputhje me kapitullin 23 për të drejtat e njeriut. Plani i Veprimit për Garancinë e Fëmijëve, aktualisht po zbatohet në një sërë vendesh të Bashkimit Evropian, dhe ashtu sikurse Plani i Garancisë Rinore do të synojë të ndërtojë modele, mjete dhe financim për adresimin e fëmijëve vulnerabël, të garantojë një plan për reduktimin e varfërisë së fëmijëve dhe nxitur mirëqenien e tyre.”

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026²², në vizionin e tij ka: “Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.”

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifike ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: “Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t’u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër të tjera synon të sigurojë një kujdes të veçantë vajzave dhe djemve në rrezik braktisje, si dhe atyre nga grupet vulnerabël: fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, në përgjithësi, nga grupet shoqërore të marginalizuara, vajzave dhe djemve që rikthehen nga emigracioni, fëmijët viktime dhe viktime të mundshme të trafikimit, fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane²³.

Në analizë për sa më sipër, me miratimin e këtij dokumenti strategjik, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore, ndër të tjera edhe

²² Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021.

²³ Paragrafi i fundit i faqes 61, të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

paketa mbështetëse për arsimimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë duke i garantuar atyre një jetesë sa më dinjitoze.

Komisioneri vlerëson se, në të njëjtën linjë dhe në harmoni me sa më sipër, duhet të jenë dhe veprimet e masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë, lidhur me këto kategori, veprime të cilat përveçse në respektim të kuadrit ligjor, duhet të kenë në konsideratë edhe parimin njerëzor dhe trajtimin me ndjeshmëri të veçantë, pikërisht për shkak të vulnerabilitetit të tyre.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit, duke u bazuar në kriteret e vendosura nga pika 12, e nenit 33, të LMD.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson si masë të duhur për rregullimin e situatës, marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Korçë, si institucioni përgjegjës, për trajtimin me bursë të nxënësit F.B , për vitin shkollor 2025-2026, si fëmijë që vjen nga një familje, që trajtohet me ndihmë ekonomike dhe që ndjek arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësit F.B ²⁴, për shkak të *gjendjes ekonomike*, nga ana e Bashkisë Korçë, si fëmijë i një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike.
2. Bashkia Korçë të marrë masa efektive, për trajtimin me bursë, për vitin shkollor 2025-2026, të nxënësit F.B , bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, të ndryshuar.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit F.B , nga ana e Ministrisë së Arsimit.

²⁴ Përfaqësuar nga babai, z. A.B .

4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: Gjendja ekonomike
Fusha: Arsim
Lloji i vendimit: Diskriminim+Mosdiskriminim

